



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:186891

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05498603

P.nr.44/2023

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Novobërdë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me procesmbajtësen Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të akuzuarës R. R. nga Gjilani, për shkak të veprës penale, Ngacmimi nga neni 182 pra.2, në lidhje me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tutje shkurtesa KPRK-së), të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Granit Mavriqi nga Kamenica, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1354/2023, të datës 05.09.2023, në prani të palëve më dt. 18.03.2024, shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 25.03.2024, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**E a k u z u a r a :**

**R. R.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati E., dhe e ëma Z. e lindur F., e lindur më datë 17.08.2000, në Gjilan ku edhe jeton, te banesat e Cenit, me nr. personal 1245326919, shqiptare, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, në bashkëjetesë, nënë e dy fëmijëve, e punësuar te restoranti i Stambollit, e gjendjes së mesme ekonomike, sipas deklaratës së saj nuk ka qenë e dënuar më parë për vepër tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

**Ë s h t ë f a j t o r e**

**Sepse:**

Nga dt.18.08.2023 e deri më dt.21.08.2023, në fshatin Kufcë e Epërme, K.Novobërdë, e pandehura, me qëllim të ngacmimit, shqetësimit, frikës dhe ndjenjës së pasigurisë me veprimet, sjelljen dhe komunikimin e saj është përfshirë në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ndaj të dëmtuarit – ish bashkëjetuesit të saj N. M., në atë

mënyrë që edhe pse e vetëdijshme se ishin ndarë dhe fëmijët 5 muajsh i kishte lënë në përkujdesje të dëmtuarit, e pandehura kinse me qëllimin për ti parë fëmijët në vazhdimësi të dëmtuarin e shqetëson me telefonata dhe e frikëson me sms- nga adresa "Malik Lion Rashiti", duke e sharë me fjalë të ulëta dhe e kanos me fjalët "ski me mujt as me fol ma, o budall kom me tvra ty e veten edhe babën ton, o ty kom me tvra, dije shka mke bo se as ne burg skom met shti, kom met vra", u telefonin prindërve të dëmtuarit vazhdimisht e po ashtu edhe e po ashtu edhe u shkon tek shtëpia pa ndonjë paralajmërim, ashtu që me shkrimet dhe komunikimin e saj të vazhdueshëm tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe shqetësim të madh emocional.

-Me çka ka kryer veprën penale, ngacmimi neni 182 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të të njëjtit nen dhe neneve 4, 38, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 72, paragrafi 1 pika 1.6 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364, 449 dhe 452 të KPRK-së, të akuzuarën R. R. e,

## G J Y K O N

Me dënim me kusht,

- dënim **me burgim** në kohëzgjatje prej **4 (katër) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, në rast se e akuzuara kryen veprë tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg efektiv.

I dëmtuari N. M. nga fshati Kufcë e Epërme, komuna e Novobërdës nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashton kërkesë pasurore juridike.

Detyrohet e akuzuara, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu e akuzuara obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.1354/2023, të datës 05.09.2023, ka kërkuar që ndaj të akuzuarës R. R. nga Gjilani, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Ngacmimi nga neni 182 pra.2, në lidhje me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe e njëjta të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës, konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarës për datë 18.03.2024, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, e akuzuara deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nga e akuzuara përkitazi me veprën penale me të cilat akuzohet sipas aktit akuzues.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë nga e akuzuara është bërë vullnetarisht edhe atë pas konsultimit të mjaftueshme me mbrojtësin e saj, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se e akuzuara R. R., me dashje ka kryer veprën penale: Ngacmimi nga neni 182 pra.2, në lidhje me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarën e shpalli fajtores, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjëse.

Pasi që e akuzuara e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokuroja e shtetit Kujtesa Fazliu, merastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaron: se në shqyrtimin e sotëm fillestar e akuzuara R. R. e pranoj fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë edhe atë pas konsultimit me avokatin e saj. Pranimin e fajësisë e njëjta e bëri vullnetarisht pa ndikim të dhunës, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban. Andaj kërkon nga gjykata që e akuzuara të shpallet fajtores dhe të njëjtin ta dënojë me dënim të paraparë me ligj, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, ashtu siç janë të cekura në aktakuzë në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit N. M., në fjalën përfundimtare deklaron se, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe se nuk parashton kërkesë pasurore juridike, tani me të njëjtin janë duke negociuar për ti rregulluar raportet në mes vete dhe beson që shumë shpejtë do të fillojnë që të jetojnë së bashku sepse kjo mosmarrëveshje nëmes tyre ka qenë e rastit dhe për më tepër ka qenë për shkak të ndërhyrjeve të personave të tjerë në mes tyre dhe me të njëjtin i kanë dy fëmijë -bineq të moshës 1 vjeçare.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të akuzuarës av.Granit Mavriqi, në fjalën përfundimtare deklaron se kërkon nga gjykata që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarën me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ta ketë parasysh pranimin e fajësisë që në procedurat e mëhershme penale, gjithashtu me vet faktin që bashkëshorti i saj dhe vet ajo deklaruan se janë në proces e sipër për rregullimin e raporteve bashkëshortore, konsideron se në rast se gjykata jep ndonjë dënim të lartë atëherë vet dënimi do të arrij që këto raporte të mos rregullohen e që për hir të rregullimit të raporteve dhe duke i nisur nga qëllimi i dënimit që e parasheh vet ligji, konsideron se gjykata duhet ta shqiptojë një dënim minimal ndaj të akuzuarës dhe atë nëse i shqipton dënim me burgim efektiv ti jepet mundësia që ndaj të njëjtës dënimi me burg ti zëvendësohet në dënim me gjobë.

E akuzuara R.R., në fjalën përfundimtare deklaron, e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit të saj, e pranon fajësinë, ka gabuar, është penduar, bashkëshortit tësaj, tani tëdëmtuarit i kërkon falje, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i premtion gjykatës se më nuk do ta shqetësoj bashkëshortin e saj dhe premtion se do të mundohet që me të njëjtin ti rregullojnë marrëdhëniet bashkëshortore, në mënyrë që të jetojnë së bashku për hir edhe të dy fëmijëve që i kanë, se mosmarrëveshja ka qenë e rastit. I premtion gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra penale apo të tjera, të tilla, andaj kërkon nga gjykata ta liroj nga dënimi ose t'i shqiptoj nj dënim sa më të butë konform ligjit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për këtë veprë penale të kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Për këtë rast si rrethana lehtësuese gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga e akuzuara, faktin se tani me të dëmtuarin janë duke negociuar për rregullimin e mardhënjëve bashkëshortore, po ashtu i dëmtuari, tani bashkëshorti i saj nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale. Po ashtu si rrethanë lehtësuese gjykata pati parasysh edhe pendimin e saj të shprehur gjatë seancës gjyqësore për veprën penale të kryer, ka gabuar, i premtonte gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra, si dhe as vepra të tjera penale. Ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veqanërisht rënduese për të akuzuarën, andaj duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj bazueshëm mund të pritët që ky dënim do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarës, do të ketë ndikim edukativ edhe ndaj qytetarëve tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, sikundër që do t'i kontribuojnë disiplinës dhe përgjegjësisë më të madhe të qytetarëve në përgjithësi.

I dëmtuari N. M. nga fshati Kufcë e Epërme, komuna e Novobërdës nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 449 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 të KPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për të paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë euro), si dhe 20 €, për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2023:186891, 25.03.2024**

**G j y q t a r i**

\_\_\_\_\_

Sadri Krasniqi,d.v.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.